



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Sherbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**
(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i Procedurës: objekt: “Ngritja e sistemit software së bashku me mbështetjen e pajisjeve hardware”.

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP)_30210000-4/ 51611100-9/ 48310000-4.

Vlera në monedhën ndërkombëtare euro është llogaritur bazuar në kursin e këmbimit datë 11.10.2024, i cili është në fuqi deri në mesditën e datës 14.10.2024. Bashkëlidhur DST gjendet një kopje print screen e kursit të këmbimit në momentin e hedhjes së procedurës së prokurimit në SPE, që korresponon me datën e dërgimit për publikim të formularit të njoftimit të kontratës sipas përcaktimit në pikë 2, neni 12 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

1. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës 67,500,000 (gjashtëdhjetë e shtatë milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH ose 683,198 (gjashtëqind e tetëdhjetë e tremijë e njëqind e nëntëdhjetë e tetë) Euro pa TVSH.

Lloji i procedurës së prokurimit: “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formulari i ofertes sipas Shtojcës 1;*

ç. *Lista e cmimeve të artikujve sipas Shtojcës 2.*

Argumentimi: Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 26, dhe të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP 1“. Bashkë me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe shtojcës 8 të DST-së.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare një vlerë jo më e vogël se vlera e fondit limit lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Ky kriter, është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; në pikën 1 dhe pikën 2/a të nenit 43 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore*

të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/a: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara më poshte, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Legjislatori në pikën 1 dhe pikën 2/a të nenit 43 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, ku përcaktohet; Pika 2/a: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; Referuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure AK ka menduar se vendosja e një vlere minimale të xhiros jo më e vogël se vlera e fondit limit për të cilat konkurren operatori, është një dëshmi e mjaftueshme për të krijuar bindjen tek Autoriteti Kontraktor se Operatoret Ekonomike ofertues zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 ‘Mbi Rregullat e Prokurimit Publik’, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenin 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 ‘Për Tatimin Mbi të Ardhurat’ i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do ti kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve të deklaruar si më lart.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe ligjin Nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar Autoritetin Kontraktor se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të

Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit të limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me pikën 4 të nenit 77 të Ligjit nr.162/2020, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, në të cilin gjejme të përcaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me pikën 4 të nenit 40 të VKM nr.285 date 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, në të cilin është e përcaktuar se: [...]4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe pikën 4 të nenit 40 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës siç është parashikuar nga AK.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të vërtetojë që ka të paktën 20 (njëzetë) punonjës të siguruar, ku të përfshihen jo më pak se 10 (dhjetë) Inxhinierë/Specialiste të diplomuar në degët e Inxhinierisë Elektronike / Inxhinieri Informatike / Teknologji Informacioni / Informatikë / Informatikë Matematikë / Inxhinieri Matematike dhe Informatikë / Informatikë Ekonomike / Telekomunikacion / Inxhinieri Telekomunikacion / Mekatronike / Inxhinieri Gjeoinformatikë, që do të angazhohen në implementimin e projektit, ku të vërtetohet nëpërmjet diplomës.

**Shënim:* Personeli i mësipërm duhet të ketë marrëdhënie pune me operatorin ekonomik për periudhën e 3 mujorit të fundit, e vërtetuar kjo me formularin e E-sig të listëpagesave.

**Shënim:* Me këtë numër minimal të kërkuar synohet të garantohet gjatë gjithë kohës ofrimi i shërbimit dhe prandalohen rastet e pamundësisë së prezencës së stafit për arsye të ndryshme objektive (leje vjetore, raport mjekësor, trajnime, etj.).

***Shënim:* Kriteret për punonjësit në fazën e ofertimit të operatoreve ekonomike do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Deklarimin nga Operatori Ekonomik të stafit të angazhuar (emër mbiemër), profilin e tyre (cerifikimin, diplomimin dhe vitet e eksperiencës), citimin e dokumentacionit provues të kërkuar për secilin prej tyre. Në rastet kur Operatori Ekonomik do të shpallet fitues duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 pika (4) të LPP, ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.” si dhe nisur nga rëndësia e këtij projekti, i cili përveç veprimtarisë funksionale të tij ka impakt të drejtëpërdrejtë mbarëvajtjen e punës dhe lehtësimin e shërbimit që ofrojnë për qytetarët dhe bizneset. Kërkohet një numër prej 10 inxhinierësh në krahasim me numrin 20 të punonjësve total të siguruar, në mënyrë që AK, të jetë i garantuar se projekti do të zhvillohet dhe implementohet nga Operatori Ekonomik me qëndrueshmëri të provuar në treg dhe me organikë të brëndshme të bazuar mbi inxhinierë të kualifikuar që përputhen me objektin e prokurimit. Gjithashtu ky kriter demonstroi aftësinë e operatorit ekonomik për të përmbushur objektivat e prokurimit. Nisur nga metodologjia e shërbimeve që do të ofrohen dhe rëndësia e Sigurisë së Informacionit, është e nevojshme që operatori ekonomik të ketë minimalisht punonjësit e kërkuar sipas këtij kriteri.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij:

- a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim projekti;
- b) Të paktën 5 (pesë) punonjës të certifikuar si zhvillues/programues software ne JAVA, .NET, PHP, C++ ose ekuivalent. Certifikimet/Transkriptet duhet të jenë të lëshuara nga Microsoft/Oracle ose ekuivalent;
- c) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për testues programi;
- d) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar si administrator/ specialist implementimi për bazat e të dhënave;
- e) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente);
- f) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në sisteme operimi OS (operating system);
- g) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në sigurinë dhe riskun në ambientin kibernetik. (PMI-RMP, CRISC ose ekuivalent);
- h) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për Arkitekturën e Zgjidhjeve (Solutions Architect) niveli Ekspert;
- i) Të paktën 1(një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e pajisjeve server;
- j) Të paktën 2(dy) punonjës të certifikuar për menaxhimin e pajisjeve storage;
- k) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si Inxhinierë DevOps;

**Shënim:* Një punonjës mund të ketë më shumë se një certifikim.

**Shënim:* Kërkesat për certifikimet e mësipërme duhet të vërtetohen me Certifikatat ose Transkriptet përkatëse (të përkthyer në shqip dhe të noterizuar).

**Shënim:* Personeli i mësipërm duhet të ketë marrëdhënie pune me operatorin ekonomik për periudhën e 3 mujorit të fundit, e vërtetuar kjo me formularin e E-sig të listëpagesave.

**Shënim:* Me këtë numër minimal të kërkuar synohet të garantohet gjatë gjithë kohës ofrimi i shërbimit dhe prandalohen rastet e pamundësisë së prezencës së stafit për arsye të ndryshme objektive (leje vjetore, raport mjekësor, trajnime, etj.).

**Shënim:* Kriteret për punonjësit në fazën e ofertimit të operatoreve ekonomike do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Deklarimin nga Operatori Ekonomik të stafit të angazhuar (emër mbiemër), profilin e tyre (cerifikimin, diplomimin dhe vitet e eksperiencës), citimin e dokumentacionit provues të kërkuar për secilin prej tyre. Në rastet kur Operatori Ekonomik do të shpallet fitues duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri.

a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim projekti;

Argumentimi: Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën një punonjës të certifikuar si menaxher projekti, për të siguruar zhvillimin e suksesshëm të projektit sipas standarteve duke marrë në konsideratë rëndësinë e projektit. Një menaxher projekti është përgjegjës për ndjekjen e të gjithë ciklit të një projekti implementimi, që prej analizës dhe dizenjimit të kërkesave, parametrizimeve dhe konfigurimeve të sistemit, testimit, trajnimit dhe dokumentimit të projektit. Projekt menaxheri, duke marrë parasysh kompleksitetin e projektit, afatet kohore të kryerjes së shërbimit, shumëllojshmërinë e shërbimeve të kërkuara, do të siguronte që çdo pikë e shërbimeve të kërkuara të kryhen me sukses dhe cilësi si edhe në kohë e afat sipas përcaktimeve të kësaj kontrate. Gjithashtu vlen të theksohet që me këtë numër minimal të kërkuar synohet të garantohet gjatë

gjithë kohës ofrimi i shërbimit dhe prandalohen rastet e pamundësisë së prezencës së stafit për arsye të ndryshme objektive (leje vjetore, raport mjekësor, trajnime, etj).

b)Të paktën 5 (pesë) punonjës të certifikuar si zhvillues/programues software ne JAVA, .NET, PHP, C++ ose ekuivalent. Certifikimet/Transkriptet duhet të jenë të lëshuara nga Microsoft/Oracle ose ekuivalent;

Argumentimi: Punonjësit e certifikuar sipas kriterit të mësipërm konsiderohen tepër të rëndësishëm për këtë projekt pasi puna e tyre do të konsistojë në përgatitjen e ndërfaqeve grafike që janë prezantimi i sistemit për përdoruesit. Ndërfaqet dhe paraqitja vizuale e tyre është një element shumë i rëndësishëm dhe konsiderohet një nga specifikat që kanë impakt të drejtpërdrejtë për përdoruesit e sistemit.

Ndërfaqet janë kritike pasi ato shërbejnë si prezantimi i parë i ndërveprimit të përdoruesit dhe sistemit. Krijimi i ndërfaqeve të vlefshme dhe në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira duke garantuar dhe realizimin e kërkesave të përcaktuara në termat e referencës do të mundësojë për AK që të rritet efienca e përdorueshmërisë së sistemit.

b) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për testues programi;

Argumentimi: Në mënyrë që kërkesat funksionale dhe teknike të përmbushen sipas kushteve të kontratës, duhen kryer teste të specializuara sipas praktikave të njohura ndërkombëtarisht. Kjo mund të sigurohet nëpërmjet punonjësve të certifikuar si testues të kredituar programi. Keto punonjës duhet të kenë njohuri të thella në strategjitë dhe metodologjitë e testimit, duke siguruar cilësi të lartë dhe performancë të përmirësuar për zgjidhjen. Përmes testimit të programeve, ai duhet të sigurojë identifikimin dhe korrigjimin e gabimeve përpara se të vihen në përdorim funksional.

d) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar si administrator/ specialist implementimi për bazat e të dhënave;

Argumentimi: Administrimi i bazës së të dhënave përfshin përdorimin e mjeteve dhe teknologjive të specializuara për monitorimin, menaxhimin dhe përmirësimin e bazës së të dhënave. Punonjësit e certifikuar kanë njohuri të specializuara për këto mjete dhe teknologji, ku përdorin këto mjete për të siguruar që bazat e të dhënave janë të mirë-administruara dhe të funksionojnë me efikasitet maksimal, në mënyrë që AK të sigurohet për një administrim cilësor dhe efikas të bazës së të dhënave.

e)Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente);

Argumentimi: Kërkesa për dy punonjës të certifikuar për "ITIL" ose ekuivalente lidhet me rezultatet që duhet të përmbushen nga Operatori Ekonomik, sipas kërkesave të shprehura në DST ku përcaktohen kohët e ndërhyrjeve dhe termat e tjera të nivelit të shërbimit SLA (shërbimet e mirëmbajtjes).Një çertifikim ITIL ose ekuivalente është një set praktikash dhe kuadri rregullash dhe idesh për realizimin e shërbimit në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, që është pjesë e qëllimit të projektit të autoritetit kontraktor. Kërkesa për çertifikim ITIL ose ekuivalente, i dëshmon autoritetit që operatori ekonomik, nëpërmjet stafit të çertifikuar si më sipër, garanton ideimin dhe konceptimin e shërbimeve IT të projektit në mënyrë të menaxhueshme sipas standardeve ndërkombëtare të njohura, në gjithë ciklin e tyre.

f) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në sisteme operimi OS (operating system);

Argumentim: Përfshirja e të paktën një punonjës të certifikuar në sisteme Operimi OS (operating system) është kritike për sigurimin e qëndrueshmërisë dhe performancës së sistemeve operative. Këta punonjës kanë njohuri të specializuara në instalimin, konfigurimin dhe menaxhimin e sistemeve operative, duke siguruar që sistemet operative të funksionojnë me efikasitet dhe siguri, duke u marrë me përditësimet e nevojshme, sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave.

h) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në sigurinë dhe riskun në ambientin kibernetik. (PMI-RMP, CRISC ose ekuivalent);

Argumentimi: Objekti i kësaj procedure ka në thelb një nga infrastrukturat dhe platformat më të rëndësishme të Autoritetit Kontraktor, e cila shërben si një urë ndërlidhëse midis sistemeve të tjerë shërbim ofruese. Duke mbajtur në konsideratë që kjo platformë (infrastrukturë) afekton, përveç sa vetë trajton, edhe efektivitetin e proceseve të punës që menaxhohen nga platforma të tjera, menaxhimi i riskut kibernetik është një element shumë i rëndësishëm. Për këtë arsye, AK kërkon të sigurohet përmes këtij kriteri, që OE do të ketë kapacitetin e nevojshëm teknik për të menaxhuar në vijimësi risqet kibernetike.

g) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për Arkitekturën e Zgjidhjeve (Solutions Architect) niveli Ekspert;

Argumentimi: Përfshirja e punonjësve të certifikuar në Arkitekturën e Zgjidhjeve në nivelin Ekspert në zhvillimin e këtij projekti është shumë e rëndësishme për të siguruar që strategjia për zhvillimin e projektit të jetë e qartë dhe efektive. Duke menaxhuar rreziqet potenciale dhe duke përdorur teknologjitë më bashkohore, arkitekti i zgjidhjeve optimizon performancën dhe garanton efektivitetin e ekipeve të zhvillimit në bashkëpunim me palët e tjera të interesuara.

i) Të paktën 1(një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e pajisjeve server;

Argumentimi: Kjo kontratë ka për detyrë të instalojë dhe mirëmbajë pajisjet fizike Hardware Server me disponueshmëri shume të larte 24/7, për këtë arsye është kërkuar që personeli të jetë i çertifikuar në Server për të përmbushur sa më mirë instalimin dhe shërbimin e mirëmbajtjes. Operatori ekonomik duhet të ketë persona të specializuar për menaxhimin dhe implementimin e pajisjeve servera.

j) Të paktën 2(dy) punonjës të certifikuar për menaxhimin e pajisjeve storage;

Argumentimi: Ky projekt parashikon instalimin, konfigurimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve Storage në të cilat ruhen skedaret/file-t e bazës së të dhënave dhe aplikacionet kryesore të sistemit software. Për këtë arsye është kërkuar që personeli të jetë i çertifikuar për pajisje Storage, për të përmbushur sa më mirë shërbimin e instalimit, konfigurimit, mirëmbajtjes dhe për të siguruar minimizimin e kohës së humbjes së shërbimit në rast difekti të pajisjeve Storage.

k) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si Inxhinierë DevOps;

Argumentimi: Përfshirja e të paktën një punonjësi të certifikuar si Inxhinierë DevOps është e rëndësishme për të siguruar zhvillimin dhe shpërndarjen në mënyrë të shpejtë, të qëndrueshme dhe të automatizuar. Këta specialistë kanë njohuri të thella në automatizimin e proceseve të zhvillimit, testimit, dhe implementimit duke përdorur mjete dhe teknologji të specializuara për këtë qëllim. Përveç kësaj, ata janë në gjendje të hartojnë dhe të menaxhojnë infrastrukturën e IT në mënyrë të

skalueshme dhe të sigurt, duke përdorur praktikat e mira të DevOps për të përshpejtuar ciklin e jetës së zhvillimit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standardin ISO 9001 (ose ekuivalent), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes).

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë përcaktuar bazuar në pikën 1, të nenit 79, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se:

“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit si dhe referuar nenit 44 pika 1., të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë, dhe mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusi i klientit, përshtatshmëria e burimeve të tij, kompetenca/ profesionalizmi i punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimi i cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimeve që ofron, garantimi i një procesi cilësor të furnizimit e shërbimit sigurimi i konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Përmbushja e standardeve ose ekuivalent është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standardeve të cilësisë.

(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes).

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të jetë i çertifikuar me standardin ISO 20000 (ose ekuivalent) për sistemin e menaxhimit të shërbimit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 79 të LPP, nenit 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të shërbimit. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Standardi ISO 20000 (ose ekuivalent) përcakton kriteret për planifikimin, krijimin, menaxhimin, monitorimin, rishikimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e qasjes së menaxhimit të shërbimeve që fokusohen në teknologjitë e informacionit. Përbushja e standardeve ose ekuivalent është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik të demonstroj aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht shërbime që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve, pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit.

(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes).

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të jetë i çertifikuar me standardin ISO 27001 (ose ekuivalent), për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 79 të LPP, nenit 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Ky standard specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit. Vlerësimi i rreziqeve të sigurisë së informacionit dhe veprimi ndaj këtyre rreziqeve (I ashtuquajtur “trajtimi i rreziqeve”) përmes kontrolleve të sigurisë së informacionit në pajtim me kërkesat e standardit përfaqësojnë një bazë të sigurt për të siguruar konfidencialitetin, disponueshmërinë dhe integritetin e informacionit përkatës dhe arritjen e

objektivave të dëshiruara të sigurisë. Siguron një kornizë për zbatimin e politikave, procedurave dhe masave në proceset e menaxhimit të rrezikut të informacionit të organizatës. Nisur nga rëndësia e kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të sigurisë së informacionit, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht shërbime që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve, pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së .

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën/certifikatat ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog në gjuhën shqipe ose angleze (per operatoret e huaj) për çdo produkt, ku të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike, për të gjetur pasqyrim për parametrat teknike të produktit (*shih specifikimet teknike*) të kërkuara nga autoriteti kontraktor dhe të ofruara nga operatori ekonomik. Në katalogë, duhet të markohet me ngjyrë të qartë sistemi/pajisja që ofrohen dhe të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara për to.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 40 dhe neni 44, pika 1 “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimi. Kërkesa për deshmim teknike të kërkuara, test raportet nga autoriteti kontraktor për mallrat të cilat operatori ekonomik do të ofertojë, në mënyrë që të vërtetohet se këto mallra janë prodhuar sipas standarteve dhe kërkesave të kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, është në të drejtë të autoritetit kontraktor, i cili në kriteret e veçanta të kualifikimit të kërkojë dokumentacion provues për të vërtetuar se mallrat i plotësojnë kërkesat e cilësisë.

2.3.8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë nje deklaratë ku konfirmon se do te kryeje analizen, furnizimin, instalimin, konfigurimin, implementimin dhe vënien në funksion të sistemeve dhe pajisjeve, si dhe te marr përsipër trajnimin e përdoruesve.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër analizen, furnizimin, instalimin, konfigurimin, implementimin dhe vënien në funksion të sistemeve dhe pajisjeve, si dhe te marr përsipër trajnimin e përdoruesve. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që shërbimi objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë nje deklaratë do garantojë mbarëbajtjen e sistemit për një periudhë 12 (dymbëdhjete) muaj nga data e marrjes në dorëzim të tij.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin dhe shërbimin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që shërbimi dhe malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimin ose riparimi i tyre.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vetëdeklarim garancie për artikujt e kërkuar dhe në rast shpallje fitues duhet ti lëshojë Autoritetit Kontraktor fletë garanci si më poshtë vijon:

1. Server për aplikacion 3 vjet garanci
2. Server për database 3 vjet garanci
3. Paisje sigurie firewall 3 vjet garanci
4. SAN Switch 3 vjet garanci
5. Software backup 3 vjet garanci
6. Platforme për menaxhimin e infrastrukturës virtuale 3 vjet garanci
7. UPS 3 vjet garanci
8. Storage Kryesor 3 vjet garanci
9. Skaner A4 3 vjet garanci
10. Skaner Fotografik 3 vjet garanci

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimin ose riparimi i tyre.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 15, pika 3/b dhe nenit 40, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike. Specifikimet teknike, për mallrat dhe shërbimet objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson shërbimet e mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara

si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimitisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “Ngritja e sistemit software së bashku me mbështetjen e pajisjeve hardware”. Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.